



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**) e Ligjit nr. 03/L - 40, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d**) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 05.01.2022, merr këtë

V E N D I M
P Ë R
FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS
SË KUVENDIT PËR VITIN 2022

I. Miratohet Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.

II. Grupi punues nga pika I e këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit,
2. Feim Osmani, LVV, anëtar,
3. Fisnik Osmani, LDK, anëtar,
4. Granit Greci, PDK, anëtar,
5. Valbona Vitia, AAK, anëtare,
6. Gëzim Mehmeti, AKR, anëtar,
7. Alban Zogaj, përfaqësues i ekzekutivit, anëtar,
8. Luljeta Selimi, përfaqësuese e Sektorit për punë të Kuvendit, anëtare,
9. Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, anëtar.

III. Detyrë e grupit punues të cekur në pikën II të këtij vendimi, është që në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Kuvendi i Komunës me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, dispozitat e ligjeve të tjera - pjesën me kompetencë të komunës, aktet nënligjore dhe Statutin e Komunës, të hartojë planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022. Pas hartimit të planit final, grupi punues do ta prezantojë para Kuvendit të Komunës për miratim.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-020/01-3803/22, më 10.01.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

